

VENDIM
Nr. 219, datë 20.12.2019

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO POWER PANARIT” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALI
“VILE” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1994 kW
(ndryshuar me vendimin nr. 191, datë 20.11.2020)**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”; si dhe nenit 15, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 20.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 119/1 prot., datë 17.12.2019, të Drejtorisë së Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me “Licencimin e shoqërisë ‘Hydro Power Panarit’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali ‘Vile’ me kapacitet të instaluar 1994 kW,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 157, datë 29.10.2019, “Filloi procedurën për licencimin e shoqërisë ‘Hydro Power Panarit’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i ‘Vile’ me kapacitet të instaluar 1994 kW, për një afat 30-vjeçar”.

- ERE, me shkresën nr. 32/44 prot., datë 31.10.2019, ka bërë publikimin në median e shkruar për “Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i ‘Vile’” dhe ka ftuar palët të bëjnë komente dhe sugjerime.

- ERE, me shkresën me nr. 587/1 prot., datë 4.11.2019, ka njoftuar shoqërinë lidhur me vendimmarrjen e Bordit, për “Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë ‘Hydro Power Panarit’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i ‘Vile’, si dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar”.

- ERE me shkresat nr. 587/2 prot., datë 20.11.2019, nr. 587/4 prot., datë 11.12.2019, ka rikujtuar subjektin për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Shoqëria “Hydro Power Panarit” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 587/3/4 prot., datë 27.11.2019, ka depozituar dokumentacionin e munguar.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 29.10.2015, është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sh.p.k., konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUI) L52229023C.

- Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti, ndër të tjera, është edhe: “Ndërtimi, operimi, shpërndarja, shitja e energjisë elektrike të hidrocentralit mbi lumin Panarit. Prodhim dhe shitje energjie elektrike”.

- MIE, me miratimin përfundimtar nr. 2441/7 prot., datë 6.7.2017, ka miratuar ndërtimin e HEC-it “Vile” me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujërat e rrjedhjes së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panaritit, degë e lumit Osum, të qarkut Korçë.

- MIE, pas miratimit përfundimtar, ka lidhur me shoqërinë “Hydro Power Panarit” sh.p.k., kontratën me nr. 1951 rep.; nr. 882/2 kol., datë 4.9.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Vile”, me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujërat e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panarit, degë e lumit Osum, qarku Korçë”.

- Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 49 vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj me të drejtë ripërsëritje.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit nr. 109, datë 29.6.2015, nuk rezultoi të këtë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Hydro Power Panarit” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Vile”.

- Aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Panariti” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë vijon:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për HEC-in, (neni 9, pika 4.1.1; pika 4.1.2 ; pika 4.1.3, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, gjerat: “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Në kuptim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hydro Power Panariti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Vile” me fuqi 1994 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e ujit, të rinovuar, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit, në datën 11.5.2022.

3. Shfuqizuar.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti